


📁 Projekti 3D-IMP-ACT



<i>Buxheti për IKTK:</i>	128,641.84 €
<i>Periudha e zbatimit:</i>	Prill 2018 – Dhjetor 2020
<i>Investitori:</i>	Programi Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020 në masën deri 85%, dhe bashkëfinancim nga buxheti i shtetit në masën 15%.
<i>Përfitues:</i>	IKTK-ja në cilësinë e Partnerit në Projekt
<i>Objektivat e Projektit:</i>	Ky projekt, synon promovimin dhe vlerësimin e trashëgiminë natyrore dhe kulturore ndërmjet shteteve partnere Itali-Shqipëri-Mal i Zi, në një mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse që ndikon në mbrojtjen dhe cilësinë e mjedisit si bazë për çdo lloj promovimi turistik. Projekti gjithashtu synon krijimin e produkteve digjitale, modelet 3D VR/AR dhe ture, artefakte makete 3D të printuara të objekteve, rrjete "virtuale" që lidhin sitet e trashëgimisë kulturore të përzgjedhura nëpërmjet platformës WebGIS.

Projekti 3D-IMP-ACT “*Virtual reality and 3D experiences to IMProve territorial Attractiveness, Cultural heritage smart management and Touristic development*”, është projekt i cili realizohet në kuadër të Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020.

Programi Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit për Para-Anëtarësim (IPA II), ka një buxhet të përgjithshëm prej **92.707.558,00 Euro** (përfshirë 15% bashkëfinancim kombëtar).

Objektivi i këtij programi është të promovojë rritjen ekonomike dhe të intensifikojë bashkëpunimin në zonën e ulët të Adriatikut, duke zbatuar veprime të përbashkëta midis aktorëve institucionalë dhe jofitimprurës kombëtarë dhe rajonalë dhe duke nxitur një zhvillim të zgjuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Partnerë në projekt: Politekniku i Barit, IT (*Partner Lider*), Polo Museale della Puglia (IT), Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (AL), Universiteti Politeknik i Tiranës (AL), Universiteti Crne Gore Podgorica (ME).

Faqe Web: 3dimpact.italy-albania-montenegro.eu

Projekti 3D-IMP-ACT, ka mundësuar krijimin e një platforme online për lidhjen e të gjitha siteve të përzgjedhura si raste studimore të projektit në të tre shtetet partnere. Platforma <https://3dimpact.poliba.it/lm/index.php/view/map/?repository=3dimpact&project=map>, ofron modelet digjitale të siteve, ture virtuale si dhe informacion të detajuar mbi to. Parku arkeologjik Apoloni, Kalaja e Bashtovës, Kalaja e Peqinit janë ndër rastet studimore në Shqipëri të cilat janë pjesë e platformës. Projekti ka mundësuar gjithashtu krijimin e tre laboratoreve për përdorimin e teknologjive 3D, njëri prej të cilëve është instaluar pranë zyrave të IKTK-së. Produkte të tjera të projektit janë materiale informuese dhe promovuese, aktivitete dhe workshop-e për informimin dhe përfshirjen e moshave të reja, skanim dhe printim 3D i modeleve digjitale të objekteve të trashëgimisë etj.

Produktet e realizuara në kuadër të projektit:

- ❖ Laborator për përdorimin e teknologjive digjitale 3D në ambientet e IKTK-së dhe trajnim i stafit të IKTK-së.
- ❖ 6 objekte të përzgjedhura në koleksionin e MHK-së të digjitalizuara, skanuara dhe të printuara si kopje 3D në shkallë – UPT, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i prodhim menaxhimit.
- ❖ Përkthime të printuara në alfabetin brail për 6 objektet e skanuara, si dhe për 23 vitrinat e Muzeut arkeologjik të Apolonisë.
- ❖ Rikonstruksioni hipotetik 3D i Kalasë së Bashtovës dhe tur virtual.
- ❖ Aktivitet promovues “Preke Trashëgiminë” në datën 29 shtator 2020.
- ❖ Materiale promocionale të komunikimit digjital.
- ❖ Video Promovuese – Monumenti i Agonotetëve
- ❖ Katalog “Apolonia përmes Artit dhe Teknologjisë”.
- ❖ Fletëpalosje mbi parkun arkeologjik Apoloni
- ❖ Pjesëmarrje në konferencën finale të projektit nga ana e stafit të IKTK-së.



Buxheti për IKTK:

69,570 €

Periudha e zbatimit:

Maj 2019 – Qershor 2022

Investitori:

Programi Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020 në masën deri 85%, dhe bashkëfinancim nga buxheti i shtetit në masën 15%.

Përfitues:

IKTK-ja në cilësinë e Partnerit në Projekt

Objektivat e Projektit:

Të kontribuojë në një bashkëpunim më të mirë të zonës për shpërndarjen e produkteve inovative kulturore dhe krijuese përmes Mobilitetit Rajonal të Arteve dhe programit të vizitave dhe platformës së një rrjeti të përbashkët ndërkufitar. Rëndësia qëndron në krijimin e një sinergjie midis këtyre sektorëve dhe fillimin e një platforme të qëndrueshme për bashkëpunim, shkëmbimin e njohurive, informacionit, planeve dhe veprimeve të përbashkëta, në mënyrë që të ndajmë potencialin krijues në të gjithë rajonin.

Projekti 3C “*Cross-border exchange for the development of Cultural and Creative industries*”, është projekt tematik dhe realizohet në kuadër të Programit IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020.

Programi Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit për Para-Anëtarësim (IPA II), ka një buxhet të përgjithshëm prej **92.707.558,00 Euro** (përfshirë 15% bashkëfinancim kombëtar). Objektivi i këtij programi është të promovojë rritjen ekonomike dhe të intensifikojë bashkëpunimin në zonën e ulët të Adriatikut, duke zbatuar veprime të përbashkëta midis aktorëve institucionalë dhe jofitimprurës kombëtarë dhe rajonalë dhe duke nxitur një zhvillim të zgjuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Partnerë në projekt:

Ministria e Kulturës e Republikës së Malit të Zi (*Partner lider*), partnerët e tjerë: nga Shqipëria Ministria e Kulturës (MK), Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), nga Italia Rajoni Pulias (Regione Puglia – Dipartimento Turismo, economia della cultura e valorizzazione territoriale), Rajoni i Molizes (Regione Molise) si dhe Fondazione Molise Cultura.


Faqe Web: <https://3c.italy-albania-montenegro.eu/>

IKTK-ja është pjesë e këtij projekti kryesisht me aktivitete që mbështesin objektivin kryesor të projektit tematik që janë investimi që do të realizohet nga Ministria e Kulturës – “Rivitalizimi dhe Rikualifikimi i Territorit të Ish-Kinostudios”.

Objektivat specifikë të Projektit:

- Vendosja e platformave dhe rrjeteve të bashkëpunimit ndërkufitar në industritë kulturore dhe krijuese në mënyrë që të zhvillojnë së bashku produktet dhe shërbimet e trashëgimisë kulturore të zonës së synuar.
- Rritja e një niveli dhe cilësia e një mbështetje inovative jo-financiare për ndërmarrjet që merren me kulturën dhe sektorin krijues, përmes Mobilitetit Rajonal të Arteve dhe programit të vizitave

Aktualisht IKTK-ja nëpërmjet stafit të angazhuar për mbarëvajtjen e projektit ka vijuar me realizimin e objektivave të projektit, duke realizuar procesin e identifikimit të sipërmarrjeve të industrive krijuese të cilat lidhen me trashëgiminë kulturore materiale. Produkti i realizuar është një databazë me emrat dhe kontaktet e siguruara të këtyre sipërmarrjeve. Produkti është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore dhe NGO-ve të cilat kanë patur më parë bashkëpunime me këto sipërmarrje.



Buxheti për IKTK:

113,212.22 €

Periudha e zbatimit:

Mars 2019 – mars 2022

Investitori:

Programi Interreg Balkan-Mediterranean 2014-2020 në masën deri 85%, dhe bashkëfinancim nga buxheti i shtetit në masën 15%.

Përfitues:

IKTK-ja në cilësinë e Partnerit në Projekt

Objektivat e Projektit:

Projekti synon të analizojë dhe vlerësojë mbrojtjen dhe promovimin e burimeve natyrore dhe kulturore në të gjithë territorin Ballkan-Mesdhe, me objekt kryesor planifikimin e integruar dhe strategjitë e përbashkëta të menaxhimit të vlerave natyrore kulturore të evidentuara ndërkombëtarisht (Natura 2000, Zonat Ramsar etj.) si dhe zona të mbrojtura nga UNESCO etj.

Projekti **Mo.Na "Monuments in Nature: A Creative Co-existence"**, është projekt i cili realizohet në kuadër të Programit Interreg Balkan Mediterranean 2014-2020 dhe bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian (ERDF dhe IPA II) si dhe nga Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse.

“Balkan-Mediterranean 2014-2020”, është një program bashkëpunimi, që bashkon pesë (5) vende, tre (3) shtete anëtare të BE (Bullgaria, Qipro dhe Greqia) dhe dy (2) vende kandidate, Shqipëria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut. Ky Program bashkëpunimi është bashkëfinancuar nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (ERDF) me vlerë prej 28.330.108,00 Euro. Mbështetja totale nga fondi i Instrumentit për Ndhmën e Para-Anëtarësimin (IPA) llogaritet në 5.126.138,00 Euro. Për fushën e bashkëpunimit të përgjithshëm, zbatohet një normë e bashkëfinancimit prej 85%. Prandaj, buxheti i përgjithshëm i Programit, duke përfshirë bashkëfinancimin kombëtar, është **39.727.654,00 Euro**.

Partnerë në projekt:

European Centre for Byzantine and Post Byzantine Monuments (Greqi) - *Partner Lider*, partner të tjerë: nga Greqia Ephorate of Antiquities of Cyclades, Municipality of Thira, Hellenic Centre for Marine Research; nga Qipro Department of Forests of the Ministry of Agriculture, Rural Development and Environment, Society of Cypriot Studies; nga Bullgaria Municipality of Nessebar, nga Shqipëria Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore; si dhe *Partner vëzhgues*: nga Greqia Greek Planners Association, The Ecumenical Patriarchate.

Faqe Web: <http://www.interreg-balkanmed.eu/approved-project/45/>

Qëllimi i projektit është të zhvillojë mjete dhe praktika të menaxhimit në sitet e përzgjedhura si raste studimore - vende me interes të lartë natyror dhe kulturor në rajonet partnere në projekt (Santorini - Greqi, Nessebar - Bullgari, Butrint - Shqipëri, Kykkos - Qipro), por edhe rajone të tjera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore që preken nga presionet lokale në shumë nivele ose nga ndryshimet klimaterike.

Rezultatet e Projektit Mo.Na në Shqipëri - rast studimor “Qyteti antik i Butrintit”:

- ❖ Platforma digjitale - <https://www.monumentnature.com/>
- ❖ Takime teknike dhe workshop ndërkombëtar me temë "Ndërveprimi midis faktorit njerëzor, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit në kuadër të ndryshimeve klimaterike – rasti i Butrintit" (5-7 Nëntor 2019).
- ❖ Realizimi i materialeve informative mbi Qytetin antik të Butrintit.
- ❖ Aktivitete ndërgjegjësuëse për moshat e reja mbi trashëgiminë mjedisore dhe kulturore “Rrugëtimi fantastik i Junia Rufinës”, (4 Tetor 2020).
- ❖ Konferencë finale: “Monumente në natyrë. Një bashkëjetesë krijuese”, (Athinë 7-9 korrik 2021).
- ❖ Hartëzimi i habitateve me qëllim përmirësimin e gjendjes së konservimit dhe për promovimin e ruajtjes së biodiversitetit në Butrint.
- ❖ Realizimi i studimeve mbi ndikimin që prania e ujërave ka në rrënojat e qytetit antik të Butrintit, Pasuri Botërore (2020).
- ❖ Punime konservimi dhe restaurimi në Portën me Kulla dhe Nymfeum – Butrint (2020-2021).
- ❖ Realizimi i brandit / markës për promovimin dhe mbrojtjen e mjediseve kulturore dhe natyrore.